

TË DREJTAT SOCIALE BRENDA NË BURG

Udhëzues Praktik për të arritur masat në mbështje të të ardhurave

**hartuar nën kujdesin e vullnetarëve të shoqatës "altro diritto"
realizuar në kuadër të projektit**

**"Të drejtat në veprim, rrjet për afrueshmëri me të drejtat sociale"
"diritti in azione, rete per l'accesso ai diritti sociali"**

(Financuar nga Direktiva 2011, neni 12, paragrafi 1, shkronja d, e Ligjit të 11 gusht 1991, n. 266, financuar nga Fondi për punën vullnetare në bazë të nenit 12, paragrafi 2 i Ligjit të 11 gusht 1991, n. 266. i Viti 2011. Botuar në Gazetën Zyrtare nr. 192 të datës 19 gusht 2011)



Shoqata Altro diritto
Qendër Dokumentimi mbi burgun,
devijimet dhe marginalizimin
Qendër Konsulence jashtëgjyqësore

Faqja Kryesore e Internetit: <http://www.altrodiritto.unifi.it>

Ky udhëzues i shkurtër i përgjigjet nevojës për tu siguruar operatorëve dhe të burgosurve një seri udhëzimesh praktike për të arritur masat që janë përcaktuar në sistemin tonë të mirëqënies (welfare) në mbështetje të të ardhurave të personave dhe familjeve të varfëra . Shumica e njerëzve të cilët hyjnë burg jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe me të ardhura nën kufirin e varfërisë, prandaj lind nevoja që tu sigurohet mundësia për të arritur masat mbështetëse në të ardhura .

Arritja e përfitimeve që siguron sistemi ynë ligjor për të mbështetur të ardhurat e individëve dhe familjeve në nevojë, është një mjet për të lehtësuar varfërinë ekstreme në të cilën gjenden mijëra të burgosur e të burgosura italyane. Njohja e pakët e të drejtave si edhe të praktikave që ndjekin entet shtetërore për dhënien e shërbimeve shpesh e bën tepër të vështirë sigurimin e të drejtave sociale. Ky udhëzues i shkurtër është projektuar për të siguruar një mjet njohjeje të kushteve që parashikon ligji.

KOMPENSIM PER PAPUNËSI VITI 2013 (INDENNITÀ DI DISOCCUPAZIONE ANNO 2013)

Mini Aspi

Zëvendëson kompensimin për papunësi të zakonshme jo bujqësore me kushte të reduktuara. Është një kompensim që jepet pasi bëhet kërkesa, për gjendje papunësie të verifikuar prej 1 Janarit 2013, për ata punëtor në vartësi të cilët kanë humbur punën jo me dëshirën e tyre.

- Gjendje papunësie të pavullnetshme.

- Të paktën 13 javë (contributi) kuota (të derdhura apo të paguara) nga aktiviteti i punës në 12 muaj përpara fillimit të periudhës së papunësisë. Për shembull, në vitin 2013, për të arritur një javë kuotash (contributi) duhet të marrësh të paktën një pagë minimale prej 198,17 € në javë, në qoftë se fitohet më pak gjatë një jave, duhet të grumbullohen pagesat e përditshme deri sa të arrihet shuma 198,17 €

Paraqitja e kërkesës

Kërkesa mund të paraqitet nëpërmjet Sportelit “Diritti in azione, rete per l’accesso ai diritti sociali”. Bëje kërkesën në Sportel për të verifikuar në se i plotëson kushtet.

Kërkesa duhet të paraqitet brenda 2 muajve dhe nis nga data e fillimit të periudhës së kompensueshme që normalisht fillon prej ditës së tetë të përfundimit të aktivitetit të fundit punësues.

Shuma dhe mënyrat e pagesës

Masa e kompensimit është e barabartë me:

- 75% të pagës mesatare mujore të tatueshme për mbulimin e sigurimeve shoqërore (imponibile ai fini previdenziali) të dy viteve të fundit, nëse ajo është e barabartë apo më e ulët nga shuma e përcaktuar nga ligji dhe e rivlersuar në çdo vit mbi bazën e ndryshimit të treguesit ISTAT (për vitin 2013 është €1.180,00). Megjithatë shuma e kompensimit nuk mund të kalojë një kufi maksimal të përcaktuar çdo vit me ligj.
- 75% të shumës së përcaktuar (për vitin 2013 është €1.180,00) shtuar me 25% të diferencës midis pagesës mesatare mujore të tatueshme dhe të 1.180,00 euro (për vitin 2013), në rast se paga mesatare mujore e tatueshme është më e madhe se sa shuma e përcaktuar e thënë më sipër, shuma e kompensimit megjithatë nuk mund të kalojë kufirin maksimal të përcaktuar çdo vit nga ligji.

Pagesa kryhet çdo muaj dhe përfshin edhe ANF (çekun për familjarët në ngarkim) në se të pëket.

ASPI (çeku social për punën)

Është një kompensim ekonomik i krijuar nga 1° Janari 2013 dhe që zvendëson kompensimin për papunësi të zakonshme jo bujqësore me kushte normale. Është një kompensim që jepet pasi bëhet kërkesa, për gjendje papunësie të verifikuar prej 1 Janarit 2013, për ata punëtor në vartësi të cilët kanë humbur punën jo me dëshirën e tyre.

Kushtet

- Gjendje papunësie të pavullnetshme.

I interesuari duhet të kryej një deklaratë pranë Qendrës së punës në territorin në të cilin banon, në të cilën dëshmon aktivitetin punësues të zhvilluar së fundi si edhe gadishmërinë e tij për të filluar një punë të re. Kjo gjë nuk u kërkohet të burgosurve të cilët janë të përjashtuar nga detyrimi (në bazë të nenit.19 L. 56/87) për tu paraqitur në qendrën e punës për tu regjistruar: të qënit në burg dëshmon në të vërtetë ekzistencën e papunësisë. Është detyrë e drejtorisë që ti komunikojë qendrës së punës përkatëse gjendjen e të qënit në burg.

Pra, nuk ju përket kompensimi nëse mardhënia e punës ka përfunduar sepse keni dashur vetë apo në marrëveshje me punëdhënsin. Ka të drejtë kompensimi punëtori/ja që është tërhequr nga puna gjatë periudhës së kujdesit për shtatëzani e lindje apo në rastet e ndërprerjes së punës për çështje të drejtë (giusta causa).

- Të paktën dy vjet sigurime (assicurazione)

Duhet të kenë kaluar të paktën 2 vjet nga derdhja e kuotës së parë të sigurimit kundër papunësisë ; Periudha dy vjeçare e referimit llogaritet duke proceduar mbrapsht qysh nga fillimi i ditës së parë në të cilën punëtori rezulton i papunë.

- Kushtet kontributive (Requisito Contributivo)

Të paktën një vit derdhje të kuotave kundër papunësisë në dy-vjeçarin e mëparshëm që paraprin fillimin e periudhës së papunësisë.

Kërkesa

Kërkesa duhet të paraqitet brenda 2 muajve dhe nis nga data e fillimit të periudhës së kompensueshme që normalisht fillon prej ditës së tetë të përfundimit të aktivitetit të fundit punësues

Shuma e kompensimit (Importo)

Një shumë mujore për të cilën kohëzgjatja, varet nga mosha anagrafike e punëtorit, rritet gradualisht gjatë tre vjeçarit 2013 -2015 (periudhë tranzitore), për tu përcaktuar në regjim që prej datës 1 Janar 2016. Sasia e kompensimit është e barabartë me:

- 75% të pagës mesatare mujore të tatueshme për mbulimin e sigurimeve shoqërore (imponibile ai fini previdenziali) të dy viteve të fundit, nëse ajo është e barabartë apo më e ulët nga shuma e përcaktuar nga ligji dhe e rivlersuar në çdo vit mbi bazën e ndryshimit të treguesit ISTAT (për vitin 2013 është €1.180,00). Megjithatë shuma e kompensimit nuk mund të kalojë një kufi maksimal të përcaktuar çdo vit me ligj.
- 75% të shumës së përcaktuar (për vitin 2013 është €1.180,00) shtuar me 25% të diferencës midis pagesës mesatare mujore të tatueshme dhe të 1.180,00 euro (për vitin 2013), në rast se paga mesatare mujore e tatueshme është më e madhe se sa shuma e përcaktuar e thënë më sipër, shuma e kompensimit megjithatë nuk mund të kalojë kufirin maksimal të përcaktuar çdo vit nga ligji.

Kompensimit mujor i aplikohet një zvogëlim prej 15% pas gjashtë muajve të parë të përfitimit dhe

një ulje e mëtejshme prej 15% pas muajit të 12-të të përfitimit.

Pagesa kryhet çdo muaj dhe përfshin edhe ANF (çeku për familjarët në ngarkim) në se të pëket.

Kompensimi mund të paguhet:

- me anë të kreditimit në llogarinë bankare apo atë postale apo me anë të librezave postale;
- me anë të urdhërshirimit (bonifico) pranë Postës Italiane në sportelin e një zyre të postës e cila gjendet në kodin e anagrafit postal (CAP) të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit që ka bërë kërkesën për kompensim.

Sipas legjislacionit aktual, Administrata Publike nuk mund të kryej pagesa me para në dorë për kompensime në se shuma e tyre i tejkalon 1,000 €

ÇEQET FAMILJARE (ASSEGNI FAMILIARI)

Neni 23 i Rregulores së burgut (OP) thotë: "Të burgosurve dhe të internuarve që punojnë u takon për personat që kanë në ngarkim, çeku familjar në masën dhe sipas mënyrave të përcaktuara nga ligji. Çeku familjar u paguhet direkt personave që kenë në ngarkim sipas mënyrave të përcaktuara nga Rregullorja 2. "

Është një shërbim për të ndihmuar familjet me të ardhura më të ulta se kufijtë e caktuar, të vendosur çdo vit me ligj.

Kujt i takon

Të gjithë punëtorëve vartës, të papunëve, punëtorve në lëvizje (in mobilità), atyre që janë të shkurtuar nga puna (ai cassintegrati), anëtarve të kooperativave, pensionistave .Nga 1°Janari 1998 u takon edhe punëtorve (parasubordinati), d.m.th atyre punëtor që janë regjistruar me menaxhim të veçantë (legji 335/1995). Janë të përjashtuar punonjësit e pavarur të bujqësisë dhe pensionistat ish punonjës të pavarur, të cilëve u përket çeku familjar i "vjetër"

Për cilët familjar ,mund të kërkohet

- për aplikuesin e kërkesës për çekun;
- për bashkshortin me të cilin nuk jeni ndarë ligjërisht;
- për fëmijët (e ligjshëm ,të legjimituar, të adoptuar, të natyrshëm, të njohur ligjërisht apo të njohur me anë të gjykatës, të lindur nga martesë të mëparshme nga bashkshorti/ja tjetër, të marrë në besim sipas normave ligjore) si edhe për nipat/mbesat që jetojnë me aplikuesin, që i ka në ngarkim e që janë nën moshën 18 vjeç;
- për bijtë në moshë madhore që janë invalidë, për defekte mendore o fizike dhe që janë përgjithmonë në pamundësi për tju dedikuar aktivitetit punësues.
- për vellezërit, motrat dhe nipërit (fëmijë të motrave apo të vellezërve) të personit që bën kërkesën të cilët duhet të jenë në moshë të mitur, apo në se janë në moshë madhore duhet të jenë invalid, por me kusht që të jenë jetim nga të dy prindërit dhe që nuk kanë të drejtë të marrin pension si trashgimtar të mbijetuar.

Dokumentat që nevojiten:

- certifikatë të gjendjes familjare apo vetëdeklarim të gjendjes familjare sipas formularit që është ofruar nga INPS-i;
- deklaratë vërtetuese e bashkshortit/es në të cilën deklaron që nuk ka të ardhura (në se ka të

ardhuran duhet të deklaroj sa fiton) apo, si alternativë, mund të paraqitet çertifikata ISEE që kërkohet në një qendër të asistencës fiskale (CAF).

- bashkshorti/tja duhet të nënshkruaj formularin e kërkesës së çekut për familjar në ngarkim, apo si alternativë mund ti shtoj deklaratës vërtetuese të shkruajtur më sipër shprehjen në vazhdim " deklaroj që nuk marr e nuk kam kërkuar çek familjar ";

Kujt i paraqitet

Kërkesa i paraqitet punëdhënësit (drejtoria e burgut) apo direkt në INPS-in përkatës të territorit (do të thotë në territorin në të cilin gjendet i burgosuri).

ÇEK PËR FAMILJET ME TRE FËMIJË TË MITUR (ASSEGNO PER IL NUCLEO FAMILIARE CON TRE FIGLI MINORI)

Bëhet fjalë për një çek, të dhënë nga Komuna por që paguhet nga INPS-i, për ato familje që kanë të paktën tre fëmijë të mitur e që kanë pasuri dhe të ardhura të kufizuara.

Kujt i takon

Qytetarëve italian dhe të bashkimit europian banues në Itali. Është e domosdoshme që në familje të jetë të paktën njeri nga prindërit dhe tre fëmijë nën moshën 18 vjeç (këtu përfshihen dhe fëmijët e bashkshortit/bashkshortes si dhe të miturit e dhënë në besim para adoptues). Si prindi ashtu edhe tre fëmijët duhet të jenë anëtar të të njëjtës familje anagrafike. Fëmijët e mitur nuk duhet tu jenë dhënë në besim personave të tjerë.

Vlera e ISE-s nuk duhet të kaloj kufijtë e përcaktuar me ligj që varrojnë në bazë të numrit të anëtarëve në familje. Kufijtë e vlerës ISE janë të treguar si më poshtë:

Për numër anëtarësh	Kufiri ISE	Koeficienti
4	23.434,80	2.66
5	25.108,71	2.85
6	28.192,24	3.2
7	31.275,76	3.55
8	34.359,29	3.9
9	37.442,81	4.25
10	40.426,34	4.6

KËRKESA

Kërkesat duhet të paraqiten brenda datës 31 Janar 2014 për vitin 2013.

Për ato familje që, gjatë vitit 2013, janë të destinuara që të humbin kushtin e të paturit 3 fëmijë të

mitur në familjen anagrafike, koha e përshtatshme për paraqitjen e kërkesës është e kufizuar në periudhën në të cilën plotësohen të gjithë kushtet, pra para se sa fëmijët e mitur të mbushin 18 vjeç.

Kërkesa duhet të shoqërohet edhe me Deklaratën Zvëndësuese të Vetme (DSU) e cila përmban situatën e të ardhurave dhe situatën e pasurisë së familjes për të llogaritur ISE-n.

Shuma mujore e përfituesit arrin deri në 139,49 euro për vitin 2013.

Shuma e dhënë si dhe kushtet ekonomike për ta përfituar atë, rivlersohen për çdo vitë mbi bazën e ndryshimit të treguesit ISTAT të çmimeve të konsumit për familjet e punëtorëve dhe të nënpunsave.

Çeku jepet nga Komuna dhe paguhet nga INPS -i

PENSIONI I INVALIDITETIT (PENSIONE INVALIDITÀ)

KU?

Invaliditeti civil si fillim vërtetohet nga mjeku i burgut i cili, si mjek kurues, duhet të plotësoj formularin për vërtetimin e invaliditetit. Në vazhdim si formulari ashtu edhe çertifikata e burgosjes, dërgohen në rrugë telematike në zyrën që bën njohjen e invaliditetit.

Kini parasysh që çertificata duhet tu lëshohet falas të burgosurve. Dekreti legjislativ 230 i vitit 1999, paragrafi 6 i nenit 1, në fakt përcakton që të burgosurit janë të përjashtuar nga sistemi i pjesmarrjes në pagesën e shpenzimeve shëndetsore.

AFATET

I burgosuri do ti duhet ti nënshtrohet një vizite mjekësore, të kryer nga Komisioni, brenda 3 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

Pasi ka kaluar kjo kohë dhe vizita nuk i është caktuar, ai mund të paraqesi një njoftim ankese duke dërguar një letër në Seksionit të Shëndetësisë së Rajonit (all'Assessorato alla Sanità della Regione). Ky seksion cakton datën e vizitës pranë Komisionit të ASL-it përkatës brenda afatit përmbledhës prej 9 muajsh nga data e bërjes së kërkesës.

Në se njoftim ankesa paraqitet mbasi kanë kaluar gjashtë muaj nga data e kërkesës, data e vizitës caktohet brenda 90 ditësh. E gjithë procedura duhet të mbyllet brenda 9 muajsh.

Në rast se edhe pasi është kryer njoftim ankese nuk caktohet vizita mjekësore, aplikanti ka të drejtë ligjore për të apeluar në Ministrinë e Financave (tashmë quhet Ministria e Thesarit).

KËRKESA PËR NJOHJEN E PËRKEQËSIMIT (DOMANDA AGGRAVAMENTO)

Si alternativë e aplikimit të ankesës (apo akoma si edhe për vitin 2004, në rast se është kaluar afati i 60 ditëve për të paraqitur ankesë administrative) dhe nuk dëshirohet që të nisët istancë ligjore, mund të procedohet, me kërkesën për një vizitë të re për "keqësim të gjendjes", për të arritur një vlerësim për invaliditet më të madh se sa ai që u ishte njohur nga komisioni në istancën e parë.

Është e nevojshme që të tilla kërkesa të jenë të kompletuara me dokumentat shëndetsor që vërtetojnë ndryshimin e shenjave klinike të mëparshme, përndryshe përjashtohen nga verifikimi.

Në se u njihet përkeqësimi, dhe vendoset një shkallë e ndryshme invaliditeti dhe si pasojë edhe e drejta për të përfituar një trajtim tjetër ekonomik, përfitimet e reja ekonomike do të fillojnë të paguhen duke filluar nga muaji që pason datën e aplikimit të kërkesës.

Në se paraqitet kërkesa për njohjen e keqësimit ndërsa është aplikuar edhe ankesa, kërkesa për njohjen e përkeqësimit merret në shqyrtim vetëm mbas sqarimit/zgjidhjes të kësaj ankese.

ÇEKU SOCIAL (ASSEGNO SOCIALE)

Pensioni social është një formë ndihme (assistenza) që Inps-i u jep personave mbi 65 vjeç, banues në Itali, pa të ardhura apo me të ardhura më të ulta se vetë pensioni social.

U takon:

- atyre që kanë mbushur 65 vjeç
- që banojnë në të vërtetë dhe vazhdimisht në Itali të paktën prej 10 vjetësh;
- që nuk kanë asnjë të ardhur, apo kanë të ardhura më të ulta se sa janë kufijtë e përcaktuar nga ligji.

Kërkesa mund të bëhet vetëm në mënyrë telematike në siton e INPS-it